



Pranuar / Dorezuar Prilbena/Prilato Received/Delivery	29.12.2022	3	viti god year
Organ /Agestia Organ /Jednitca Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHCK	7752/2023		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD OR THE CIVIL SERVICE O KOSOVA

A.nr.1505/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje: Arben Mehmeti-kryetar; Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë; me Avdyl Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, si procesmbajtës, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1505/2023 të datës 08.12.2023 të parashtruar nga ankues [redacted] ne adresë rruga

[redacted] kundër organit të punësimit/Komunës së Fushë Kosovës, në çështjen juridike "shkelje e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1; nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 29.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.1505/2023 e datës 08.12.2023 e parashtruar nga ankuesi [redacted]

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, [redacted] (tutje referuar vetëm ankuesi), i punësuar në Komunën e Fushë Kosovës, më datë 08.12.2023, ka parashtruar ankesë me numër protokolloi 7372/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se kategorizimi i pozitës në klasën "Profesional 2" është bërë pa bazë juridike ngase klasifikimin duhet të bëhet si Specialist.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej vetëm Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 11.12.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Fushë Kosovës. Kjo e fundit, më datë 18.12.2023 ka përcjell shkresat e lëndës lidhur me çështjen për vendosje.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës si dhe shqyrtimit të pretendimeve ankimore, konstatoi se ankesa e ankuesit *është e parakohshme, sepse:*

Nga shkresat e lëndës konstatohet fakti se ankuesi është e punësuar në Komunën Fushë Kosovës dhe se i njëjti sipas Akt Emërimit të datës 13.07.2016, ushtron pozitën e punës *“Zyrtar për Ndërmarrje Publike”*.

Më tej, nga shkresat e lëndës, rezulton së ankuesi ka realizuar koeficient gjashtë (6) të pagës-sipas sistemit të vjetër të pagave, ndërsa, në muajin shkurt 2023, me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ankuesi është klasifikuar në klasën *“Profesional 2”*, me koeficient të pagës GJ37-4.9.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon së klasifikimi në klasën *“Profesional 2”*, është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe se ankuesja ka pësuar dëm si mungesë e ekuivalencës në koeficient. Në vlerësimin e ankuesit pozita e tij duhet të klasifikohet në Specialist.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenin 2, paragrafi 1, në lidhje me fushëveprimin ku parashihet se: *“1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj”*, dhe nenin 14, paragrafi 3, të këtij ligji ku përcaktohet se: *3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe rrjedhimisht, referuar këtij përcaktimi ligjor, Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e klasifikuar në shtojcën Nr. 10 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik. Në këtë rast, në pajtim me Ligjin përkatës për Zyrtarë Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.*

Kolegji i Këshillit, nga analizimi i shkresave të lëndës, ka gjetur se organi i punësimit, gjegjësisht Komuna e Fushë Kosovës, ende nuk e ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës për nëpunësit civil në kuadër të këtij institucioni, dhe se procesimi i pozitës së ankuesit në sistemin e ri të pagave, të krijuar sipas Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk është si pasojë e klasifikimit të pozitës së tij të punës, në kuptim të ligjit material, gjegjësisht Ligjit përkatës për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, por si rezultat i ekuivalencës së sistemit të vjetër me sistemin e ri të koeficienteve, të përcaktuar me Vendimin Nr. 04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Andaj, duke qenë së me nenin 29 të Rregullores (QRK), Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, pikën 5 dhe 6 të Vendimit Nr. 04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Vendimit Nr.17/162 të datës 27.09.2023, institucionet e administratës publike janë të obliguara që ta përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës në pajtim

me këtë Rregullore dhe katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se nëntë (9) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje, gjegjësisht deri me datë 31.12.2023, Kolegji i Këshillit vlerëson së ankesa e ankuesit, për kategorizimin e pozitës së tij në kategorinë Specialist është e parakohshme, dhe si e tillë, në këtë fazë, nuk i plotëson kushtet ligjore për trajtim meritot. Rrjedhimisht, e njëjta, është e papranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji i Këshillit, theksuar si me sipër, vlerëson se vetëm pas përfundimit të procesit të klasifikimit të pozitave të punës nga organi përkatës i punësimit, sipas procedurës dhe afatit të theksuar më lart, ankuesit do t'i lindë e drejta e kundërshtimit dhe ankesës për klasifikimin e pozitës së tij të punës.

Kështu që, mbështetur në nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, i Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike:Kundër këtij vendimi të Këshillit, pala e pakënaqur, e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda,A.nr.1505/2023, datë 29/12/2023

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Fushë Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

